



2417/12

15.10.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.1346Akti
Datë30.06.2015

Nr.1185 Vendimi
Datë 15.09.2015

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

GJYQTARE: Gentiana XHELILI (RROKAJ)

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 15.09.2015 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen civile nr.1346 Akti, që u përket palëve:

PADITËS: Shoqeria "TOMI" sh.p.k, me adrese ne fshatim "Morave", me administrator Tomor Duçi, përfaqësuar ne gjykim sipas prokures se posacme te dates 12.05.2015 nga Av.Armando Syri me nr.5256 license.

I PADITUR:1.Drejtorja Rajonale e Tatimeve, Berat perfaqesuar me autorizimin Nr.2417/4prot e dates 09.09.2015 nga Silvana Sallo.

2.Drejtoria e Apelimit Tatimor, me adrese Rr."Gjin Bue Shpata", godina e ish-maternitetit, Tirane perfaqesuar me autorizimin me Nr. 18669 Prot, date 05.06.2015 nga Silvana Sallo.

PERSON I TRETË: Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore, perfaqesuar ne gjykim nga Sokol Kamberime urdhrin n.51, date 25.02.2014(ne mungese).

OBJEKTI: Shfuqizimin teresisht te akteve administrative vendimit nr.4285 Prot, date 17.11.2014 "Njoftim Vlersimiper DetyrimetTatimore" te Drejtorise Rajonale Tatimore, Berat dhe vendimit nr.32364/3 Prot, date 09.04.2015 te Drejtorise seApelimit Tatimor, Tirane.

BAZA LIGJORE:Ligji nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin egjykatave administrative", ligji nr.8485,date 12.5.1999 K.Pr.Administrative,ligji nr.10279, date 20.05.2010 "Per Kundravajtjet Administrative", ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Repabliken e Shqiperise" i ndryshuar dhe aktet nenligjore te dala per zbatim te tij, ligji nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi teardhurat" I ndryshuar dhe aktet nenligjore tedala per zbatim te tij, ligji nr.7928, date 27.04.1995"Per tatimin mbi vleren e shtuar"i ndryshuar dhe aktet nenligjore tedala per zbatim te tij.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të palës paditëse, av.ArmandoSyri i cili kërkoi pranimin e kërkesë-padisë, degjoi perfaqesuesin e paleve te paditura Dega e Tatimeve Berat dhe Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, juristen Silvana Sallo e cila kerkoi rrezimin e kerkese-padise, personi i interesuar Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore,nuk u

degjua pasi rezultoi ne mungese, dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,



82

V Ë R E N

Se pala paditëse subjekti juridik shoqëria 'Tomi' sh.p.k i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kerkese-padine me objektin e mësipërm.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me vendimin nr.663, date 10.06.2015 ka vendosur te deklaroje moskompetencen lendore per gjykimin e kesaj çështje dhe dergimin e çështjes per kompetence ne Gjykatën Administrative Vlore.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ne baze te nenit 12 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykimi u zhvillua me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtar.

Ne seancen gjyqësore te datës 11.09.2015, perfaqesuesja e paleve te paditura ka kerkuar nxjerrjen e çështjes jashte juridiksionit gjyqësor me pretendimin se pala paditese nuk ka ezauruar rrugen administrative dhe gjykata pasi shqyrtoi provat e paraqitura nga palet ndergjyqese çmoi se kjo kerkese ishte e pabazuar ne ligj pasi u provua se pala paditese ka ezauruar ankimin administrativ

Rrethanat e faktit

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse subjekti Shoqëria "TOMI" sh.p.k me seli ne fshatin "Morave", Berat, ushtron veprimtari private me objekt:"*Import export tregeti shumice pakice artikuj te ndryshem, tregeti pakice Lzrburantesh, servis makinash.Aktivitete ne fushen e ndertimeve.Grumbullim dhe rigjenerim te wajrave lubrifikante dhe ushqimore teperdorura.mbetjeplastike.goma etj.*

Rezulton se ne daten 27.03.2014, kjo shoqëri i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat me kerkese per sistemim situatë per muajin dhjetor 2013 pasi jane harruar pa deklaruar disa fatura blereje.Gjithashtu është deklaruar gabim dhe vlerën e fatures se shitjes te muajit dhjetor 2013 e cila është nje fature per vete shoqërine.Gabimisht ne zerfa e situacionit jane marre çmimet e manualit te cilat mbajne brenda dhe fitimin..

Per kete arsye kan kerkuar sistemim te FDP-se per muajin dhjetor 2013.

Nga pala e paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat është kthyer pergjigje me nr.2123/2 prot, date 22.05.2014 kesaj shoqërie se per te kryer sistemim te faturave te shitjes duhet qe kjo shoqëri te plotesoje mangesite e konstatuara si me poshte:

- 1.kishte mosrakordim te sha me sht ne shumen 2409063 leke;
- Llogaritja e amortizimit është 20000 leke me teper nga norma 20% per makineri pajisje;
- 3.vlera e ndertesës ne aktive është 2409063 me pak;
- 4.Totalii aktivitet me shtesen e mesiperme është vete 40296250 leke;
- 5.te ardhurat nga shitja dhe te ardhurat nga prodhimi i aktiveve sipas

raportimit plotesojne kushtet per ekspertize te pasqyrave financiare;
6.mungon deklarimet per sherbimin kontabel dhe pjesemarrjen ne kapital;
7.mungon inventari i mjeteve te transportit.

83

Pas kthimit te kesja perjigje, nga subjekti 'Tomi' sh.p.k eshte kthyer pergjigje duke pretenduar se "per mosrakordimin e shitjeve nga shoqeria ehste bere sistemim situate ne date 26.03.2014;
2.llogaritja e amortizimit eshte bere gabimisht 20000 leke me shume,eshte 225544 leke nderkohe qe duhet te ishte 205544 leke;
3.persai perket diferneces ne vleren e nderteses eshte sqaruar se eshte bere shkresa per sistemim situate.Situacioni i fatures per vetefurnizim gabimisht eshte llogaritur me çmimet e shitjeve nderkohe qe duhet te llogaritje ne kosto.
4.kjo pike eshte sqaruar tek pika 3.
5.subjektii ploteson kushtet per ekspertize te pasqyrave finaciare dhe eshte ne procese te saj.
6.deklarata kontabel eshte plotesuar dhe gjithashtu dhe inventarin e mjeteve te transportit eshte bashkengjitur.

Me date 17.11.2014, nga Drejtoria e Tatimeve Berat eshte nxjerre njoftim vleresimi per detyrimet tatimore te papaguara me shkresen me nr. 4285 prot,ku ka vendosur:
Tatim per tu paguar: 242906 (dyqindedyzetenentemijeegjashte) leke, kamatevonesa ne vleren 12073 (dymbedhjetmijeeshatatedhjetete tre)leke,Gjoba 60727(gjashtedhjetmijeeshatateqineshtat) leke, ne total shoqeria "TOMI" sh.p.k detyrohet te paguaje 315706 (treqindepesembedhjetmijeeshatate qindeshatate) leke.

Paditesi Shoqeria "TOMI" sh.p.k ka paraqitur ankim ne Drejtorine e Apelimt Tatimor, ne Drejtorine e Pergjithshmete Tatimeve Tirane. Me shkresen me nr. 32364/1 prot, date 10.03.2015 Drejtoria e Apelitmit Tatimor I ka kerkuar shoqerise 'Tomi' sh.p.k te plotesoje dokumentacionin lidhur me plotesimin e kushtit te pageses se plote te detyrimit per tatim-fitimin(vertetimine pageses ose garancise bankare) pasi dokumenti qe eshte bashkelidhur nuk eshte as mandat pagese as ne formatin e garancise bankare por thjesht nje bllokim i caktuar lekesh date 09.12.2014 pa percaktuar afatin kohor te ketij bllokimi dhe as per llogari te kujt bllokohet kjo shume.

Qe kerkesa e shoqerise te merret parasysh duhet qe brenda 15 ditesh te plotesohet dokumentacioni i kerkuar.

Me shkresen date 16.03.2015 shoqeria Tomi sh.p.k i ka derguar dokumentacionin ekerkuar 'gaanci bankare neshumen prej 256.000 leke per njoftim vleresimi tatimor date 17.11.2014

Pas kesaj, pala e paditur Drejtoia e Apelimt Tatimor me vendimin nr.32364/3 prot, date 09.04.2015 ka vendosur: Refuzimin e ankimit, me objekt aktin administrativ Njoftim Vleresimi per detyrimet tatimore nr.4285 prot, date 17.11.2014, pasi nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lidhje me pagesen e detyrimit tatimor, para skadimit te afatit te ankimit.

Pala paditese i eshte drejtuar gjykates duke pretenduar se vendimi nr. 4285 prot, date 17.11.2014 ;Njoftim vleresimi tatimor' dhe vendimi nr./

32364/3 prot, date 09.04.2015 I Drejtorise se Apelimet Tatimor jane akte administrative qe kane dale ne kundersh timme ligjin per keto arsye;

29

Se pari: Shoqeria "TOMI" sh.p.k, ne daten 27.03.2014 ka depozituar prane Drejtorise Rajonale Tatimore, Berat kerkese per "Sistemim Situate" (ndryshim), duke arsyetuar se ne faturen e shitjes "Vete Furnizimi" date 31.12.2013, gabimisht ne zerat e situacionit jane mare per baze cmimet e manualit te cilat mbajne brenda edhe fitimit. Duke qene se fatura e dates 31.12.2013 eshte vete-furnizim duhet te ishte pa fitim per kete arsye kerkojme sistemim e FDP-se ndryshim) ne menyren si me poshte:

Rubrika 11 eshte 26 499 695 leke duhet te ndryshohet duke u bere 24 090 632 leke.

Rubrika 12 eshte 5 349 439 leke duhet 4 818 126 leke.

Rubrika 15 eshte 3 753 870 leke duhet 5 823 870 leke.

kerkesa e mesipenne eshte shoqeruar me Librin e blerjes dhe shitjes se muajit Dhjetor 2013, P-ne e muajit dhjetor 2013 dhe faturat perkatese.

Se dyti: Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat me shkresen nr.2123/2 prot, date 22.05.2014 ka njoftuar coqerine "TOMI" sh.p.k se per subjektin per vitin 2013 jane kostatuar mangesite e meposhtme:

Ka mosrakordim te sha me sht ne shiimen 2409063 leke.

Llogaritja e amortizimit eshte 20000 leke me teper nga norma 20% per makineripaisje.

Nderteses ne aktive eshte 2409063 me pak.

Totali aktiv me shtesen e mesiperme vete 40296250 leke.

Te ardhurat nga shitja dhe te ardhurat nga prodhimi aktive sipas raportimit e saj plotesojnekushtetper ekspertize te pasqyavefinanciare.

- Mungon Deklarata per sherbimin kontabel dhe pjesmarrjen ne kapital.

-Mungon inventari i mjeteve te trasportit.

Me shkresen date 02.06.2014 shoqeria "Tomi" sh.p.k i ka kthyer pergjigje DRT, Berat per njoftimin e mesiperm duke plotesuar edhe dokumentet perkatese.

Se treti: Ne baze te vleresimit nr.4132 prot, date 12.11.2014 te bere nga zyrat e DRT, Berat eshte njerre vendimi nr.4285 prot, date 17.11.2014 "Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore" me te cilen detyrohet shoqeria "TOMI" sh.p.k per "Mos raportim i plote ne deklaraten e Tatim Fitimit te fatures tatimore te shitjes nr.09, date 31.12.2013, fature i vetefurnizimit i uruacionit dhe per mosllogaritjen e sakt te amortizimit te mjeteve inventar" ne shumen 315706 leke detyrim tatimor, kamatvonesat dhe gjobe.

Shoqeria "TOMI" sh.p.k duke mos qene dakort me vendimi nr.4285 prot, date 17.11.2014 njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore" te DRT, Berat ne daten 09.12.2014 ka bllokuar shumen 256, 043.00 leke sipas Njoftim Vlersimit nr.4285 date 17.11.2014 e cila eshte e pershkruar edhe ne shkresen e dates 09.12.2014 te leshuar nga Alpha Bank. Pas bllokimit te shumes se mesiperme shoqeria "TOMI" sh.p.k ne daten 11.12.2014 ka paraqitur Kerkese Ankimore ne Drejtorine e Apelimet Tatimor, Tirane me objekt 'Kundeshtimine vendimit nr.4285 prot, date 17.11.2014 "Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore" te DRT, Berat.

Me shkresen nr.32364, date 10.03.2015, "Kerkeseperplotesim dokumentacioni" te Drejtoria e Apelimit Tatimor i eshte kerkuar shoqerise "TOMI" sh.p.k qe ne zbatim te ligjit duhet te plotesoj kerkesen me dokumentacionin se me poshte vijon:

1. Dokumentacioni qe verteton plotesimin e kushtit te pageses se plote te detyrimit per tatim-fitimin (vertetimin e pageses ose garancin bankare) tatim + kamatvonesa (pa gjobat) te percaktuar ne "Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore" nr.4285 prot, date 17.11.2014 objekt ankimi e cila duhet te jete kruer para skadimit te afatit te ankimit sipas percaktimeve ne zbatim te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 'Per Procedurat Tatimore ne R.P.SH', i ndryshuar, neni 107 dhe Udhezimit te ministrit te Financave nr.24, date 02.09.2008, i ndryshuar, ne zbatim te ligjit, pika 107.3.1, pasi dokumentacioni qe eshte bashkalidhur nuk eshte as mandat pagese, as ne formatin e garancise bankare, por thjesht bllokimi i nje shume te caktuar lekesh date 09.12.2014, pa percaktuar as afatin kohor te ketij bllokimi dhe as per llogari te kujt bllokohet kjo shume lekesh.

Ky pretendim i Drejtorise se Apelimit Tatimor nuk qendron pasi Shoqeria "TOMI" sh.p.k ne zbatim te kerkeses se mesiperme eshte paraqitur ne Banken Kombetare Tregetare dhe ka mare shkresen nr.303, date 16.03.2015 me te cilen eshte provuar se shoqeria "TOMI" sh.p.k ka lene garanci bankare per llogari te 'Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore' nr.4285 prot, date 17.11.2014, te cilen e ka bllokuar me date 09.12.2014 per llogari te "Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore", pra brenda afatit ligjor.

Me vendimin nr.32364/3 prot, date 09.04.2015 Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur:Refuzimin e ankimit, me objekt aktin administrativ Njoftim Vleresimi per detyrimet tatimore nr.4285 prot, date 17.11.2014, pasi nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lidhje me pagesen e detyrimit tatimor, para skadimit te afatit te ankimit.

Arsyetimi i Drejtorise se Apelimit, Tatimor eshte rrjedhoje i zbatimit te keq te ligjit, pasi shoqeria "TOMI" sh.p.k ne zbatim te ligjit ka bllokuar per llogari te Njoftim Vlersimit Per Detyrimet Tatimore shumen perkatese brenda afatit ligjor, fakt ky qe provohet edhe me faturat bankare perkatese.

Edhe ne temel te ceshtjes, akti administrativ "Njoftim Vleresimi Per Detyrimet Tatimore" nr.4285 prot, date 17.11.2014 i DRT, Berat eshte rrjedhoje i zbatimit te keq te ligjit, pasi shoqeria "TOMI" sh.p.k ne zbatim te nenit 67 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.P.SH", i ndryshuar dhe nenit 67 te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.24, date 02.09.2008 ka kerkuar sistemim situate (ndryshim) si rezultat i gabimit gjate plotesimit te deklarates tatimore, per te cilen DRT, Berat nuk ka vepruar sipas ligjit, per permiresimin e situates se shoqerise, por kavepruar ne kundeshitim duke e llogaritur gabimin ne deklaraten tatimore si "Mos raportim i plote ne deklaraten e Tatim Fitimit te fatures tatimore te shitjes nr. 09, date 31.12.2013, fature i vetefurnizimit i situacionit dhe per mosllogaritjen e saktete amortizimit te mjeteve inventar'.

Sa me siper, pala paditese shoqeria 'Tomi' sh.p.k ka kerkuar pranimin e kerkeses-padise duke shfuqizuar teresisht aktet administrative,vendimi nr.4285 Prot,date 17.11.2014"Njoftim Vlersimi per Detyrimet Tatimore" te Drejtorise Rajonale Tatimore, Berat dhe vendimit nr.32364/3 Prot, date 09.04.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, Tirane.

Pala e paditur Dega Rajonale e Tatimeve Berat dhe Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane nepermjet perfaqesueses se saj ka kerkuar rrezimin e kerkese-padise duke pretenduar se :

86

Se pari: Me ane te Njoftim Vlersimit nr.4285 prot. date 17.11.2014 derguar nga DRT Berat, subjektit i eshte komunikuar penaliteti ne vlere 315 706 leke te Tatim Fitimin te vitit 2013, per Mosraportim te plote te tatim fitimit te fatures tatimore shitje nr.09 date 31.12.2013. (Fature vet-furnizim i subjektit. Moslogaritja e sakte e amortizimit te shitjeve ne inventar).

Pala paditese e ka ankimuar aktin administrative per detyrimet tatimore Njoftim Vleresimit nr.4285 prot. date 17.11.2014, ne Drejtorine e Apelimit Tatimor Tirane, e cila me vendimin nr.32364/3 date 09.04.2015 (prot me DRT Berat me nr.4285/2 date 14.04.2015) ka vendosur Refuzimin e ankimit, pasi nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lodhje me pagesen e detyrimit tatimor, para skadimit te afatit te ankimit.

Shoqeria "TOMI" shpk, me date 10.12.2014 i eshte drejtuar Drejtorise se Pergjitheshme te Tatimeve, Drejtora e Apelimit Tatimor Tirane, me objekt :Kundershtim e aktit administrativ, te Njoftim Vlersimit nr.4285 prot. date 17.11.2014, te DRT Berat.

Me vendimin nr.32364/3 date 09.04.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor eshte vendosur: Reruzimin e ankimit, pasi nuk jane permbushur kerkesat dhe procedurat ne lodhje me pagesen e detyrimit tatimor, para skadimit te afatit te ankimit.

Nga ana e DRT Berat eshte paraqitur kerkesa per mospranimin e padise, kerkese per te cilen Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore me vendimin nr. date 11.09.2015 vendosi: mos pranimin e kerkeses. Ky vendim eshte ankimuar nga ana e DRT Berat Brenda afateve te parashikuara ne ligj.

Se dyti: Shoqeria Tomi shpk, i eshte drejtuar DRT Berat me shkresen me lende: Kerkese per sistemim situate, protokolluar ne DRT Berat me nr. 1994 date 27.03.2014, kerkese e cila nuk eshte marre ne konsiderate.

Me shkresen nr.2123/2 prot.date 22.05.2015 me lende Njoftim, subjekti eshte njoftuar se: ne zbatim te ligjit nr.8483, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise se Financave nr.5 date 30.01.2006 "Per Tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, kerkesave te ligjit nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" I ndryshuar si dhe kerkesave te te Udhezimit nr.2 date 04.02.2014 "Per zbatimin e procedurave te verifikimit te pasqyrave financiare per vitin fiskal 2013" te Drejtorise se Pergjitheshme te Tatimeve", subjektit Tomi per vitin 2013 i jane konstatuar keto mangesi:

Ka mosrakordim te sha (shitjet (te ardhurat) e subjektit te raportuara ne sistem) dhe sht (te ardhura te raportuara ne tatime) ne shumen 2409063 leke Llogaritja e amortizimit eshte 20000 leke me teper nga norma 20% per makineri paisje

Vlera e nderteses ne active eshte 2409063 me pake

Totali aktivitet me shkresen e mesiperme vete 40296250 leke

Te ardhurat nga shitja dhe te ardhurat nga prodhimi I aktiveve sipas raportimit tuaj plotesojne kushtet per ekspertize te pasqyrave financiare

Mungon deklarata per sherbimin kontabel dhe pjesmarrjen ne kapital

Mungon inventari i mjeteve te transportit.

Rezulton se ~~nga~~ subjekti është kerkuar vetem rregullimi situates per korigjim te fatures se shitjes (ulje te te ardhurave tatimore) nderkohe qe nuk eshte kerkuar edhe korigjim te fatures se blerjes e cila sjell si pasoj fshehje te te ardhurave ne tatime(pra kerkon te ule te ardhurat duke i mbajtur ne te njejten nivel shpenzimet te rritura) 07

Subjekti ashtu si ka kerkuar korigjim te fatures se shitjes duhet te kerkonte dhe korigjim te fatures se blerjes, sepse me ane te kesaj behet ulja e te ardhurave dhe rritja e shpenzimeve. Pavarsisht qe jemi ne situaten e vetefurnizimit subjekti ashtu si i ben vetes shitje njekohesisht ben dhe blerje.

Se treti:Subjekti duhet te paraqiste fatur tjetër shitje dhe blerje, te ndryshonte njekohesisht librat e shitjes dhe te blerjes bashkengjitur me kerkesen per korigjim ne menyre qe kjo kerkesë te merrej ne konsiderat nga ana e DRT Berat.

Me shkresen (Memo) nr.4132 prot.date 12.11.2014 me lende Vleresim deklarate nga zyra, drejtuar drejtorit rajonal, per miratimin e vleresimit tatimor per subjektin "Tomi" sh.p.k per deklaraten e tatimit te fitimit te periudhes tatimore 2013, ne shumen 2 409 063 leke ne rritje te te ardhurave dhe 20 000 leke ne ulje te shpenzimeve per logaritje me shume te amortizimit te makiner-paisjeve, rezulton se diferenca ne te ardhurat vjen si rezultat i mosdeklarimit te plote te fatures tatimore te shitjes Nr.09 date 31.12.2013 e cila eshte Fatur vet-furnizimi i subjktit, " Situacion punimesh per ndertimin e nje fabrike per riciklimin e mbetjeve" ne fshatin Morave Berat.

Subjekti per periudhen tatimore 2013, ka bere deklarimin e fatures se mesiperme ne librin e shitjes dhe te blerjes me vlere te tatueshme 26 499 695 leke, dhe ne deklaraten e Tatim Fitimit nuk e ka pasqyruar site ardhura diferencen e lartpermendur me pretendimin se fatura e shitjes eshte vetfurnizim dhe eshte pa fitim.

Kerkesa e subjektit me nr. 1944 prot.date 27.03.2014 per korigjim deklarate nuk eshte marre ne konsiderat nga ana e tyre duke i derguar njoftimin per mospranim te pasqyrave financiare pa sistemuar mangesite e mesiperme.

Se katerti:Ne zbatim te ligjit 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, Udhezimit te Ministrise se Financave nr.5 date 30.01.2006 "Per Tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar, kerkesave te ligjit nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" I ndryshuar si dhe kerkesave te te Udhezimit nr.2 date 04.02.2014 "Per zbatimin e procedurave te verifikimit te pasqyrave financiare per vitin fiskal 2013" te Drejtorise se Prgjitheshme te Timeve" dhe ky sistemim nga ana e tyre bazohet ne ligjin per procedurat tatimore, ne nenin 68.

Perfaqesuesi i Avokatures se Shtetit Zyra Vendore Vlore nuk eshte paraqitur dhe nuk ka paraqitur as prapesime lidhur me objektin e mosmarreshjes administrative.

Gjykata pasi ka administruar provat dhe ka analizuar në tërësi çështjen, çmon se kërkesë-padia është e pa bazuar në ligj dhe në prova dhe duhet të rrezohet.

KRYEQENDRUESI I KUVENDIT
DHE
KRYEMINISTRI I SHQIPËRIE

88

Arsyetimi ligjor

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "Të drejtën e padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Në nenin 17 të ligjit nr.49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative' parashikohet se: **Padia ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;** Rezulton se pala paditëse subjekti 'Tomi' nuk ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet Tatimore nxjerrë nga pala e paditur, pasi akti administrativ është nxjerre ne zbatim te ligjit material.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga Ligji 'Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë', ligji nr.8438, date 28.12.1998 'per tatimin mbi te ardhurat"i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.

Gjykata merr ne analize se pari faktin nese pala paditese ka ezauruar rrugen administrative, fakt icili eshte kundërshtuar dhe nga pala e paditur duke kerkuar nxjerrjen e çështjes jashte juridiksionit gjyqesor .

Bazuar ne provat e administaruara ne gjykim, rezulton se pala paditese ka ezauruar ankimin administrativ, duke çmuar se pretendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor se ankimi eshte paraqitur pa paguar detyrimin tatimor dhe kjo pagese eshte kryer pas skadimit te afatit te ankimit nuk qendron per arsye se;

Rezulton se njoftim vleresimi tatimor ka dale ne daten 17.11.2014 dhe i eshte njoftuar subjektit te kontrolluar dhe nga kjo shoqeri ka bere ankim ne daten 18.11.2014,pra brenda afati 30 ditor qe percakton ligji 'Per procedurat tatimore ne RSH', ankim icili eshte shoqeruar edhe me bllokimin e shumes prej 256043 leke ne banken Alpha Bank ne daten 09.12.2014 per llogari te njoftim vleresimi tatimor date 17.11.2014.

Pala e paditur nuk e ka konsideruar te rregullt kete bllokim dhe e ka njoftuar subjektin per te kryer pagesen konform dispozitave ligjore 'per procedurat tatimore' m shkresen e dates 10.03.2015 duke i lene nje afat 15 ditor per plotesimin e dokumentacionit dhe pala paaditese subjekti Tomi sh.p.k ne zbatim te kesaj detyre te lene ka vendosur garanci bankare vertetuar nga vertetimi me nr. 303 prot, date 16.03.2015 prane Bankes Kombetare Tregtare per shumen prej 256.000 leke ne favor te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat me afat vlefshmerie deri ne date 30.06.2015.

Rezulton se edhe pasi pala paditese ka vendosur perseri garanci bankare brenda aftit 15 ditor te vendosur nga vete pala e paditur, perseri pales paditese i eshte refuzuar shqyrtimi ne rruge administrative me pretendiminse nuk eshte paguar detyrimi tatimor brenda aafitit 30 ditor nga dita e marrjes dijeni te njoftim vleresimi tatimor.

Ne nenin 107 te ligjit 'Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise' te ndryshuar parashikohet se **"1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare minimalisht 6 muaj por jo me pak se afati,**

sipas te cilit vendimi ka marre forme te prere per shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.2. Shuma e pagueshme ose shumën e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni."

JP

Sa me sipër, gjykata çmon se pala e paditur ka gabuar në vendimin e saj për refuzimin e shqyrtimit të ankimit pasi provohet se pala paditese ka paguar detyrimin tatimor në formën e kërkuar nga ligji dhe brenda afatit të caktuar me ligj, siç është me bllokimin në Alfa Bank në datën 09.12.2014 dhe me garancinë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare në datë 16.03.2015 vetëm 6 ditë pasi i është lënë afat 15 ditë për plotësimin e dokumentacionit.

Në zbatim të vendimit Unifikues nr.4, datë 30.05.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykata nxjerr çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor vetëm kur paditësi për faj të tij nuk e ka paraqitur ankimin administrativ në afat ose nuk ka kompletuar dokumentet shoqëruese sipas ligjit (megjithatë organi administrativ) e ka vënë në dijeni për të metat e ankimit).

Sa me sipër, gjykata çmon se çështja është në juridiksionin gjyqësor pasi provohet se pala paditese i ka plotësuar të gjithë dokumentacionin për të shqyrtuar ankimi administrativ dhe pala e paditur pa të drejtë ka refuzuar të shqyrtojë këtë ankim.

Sa me sipër, gjykata çmon se pala paditese e ka ezauruar ankimin administrativ dhe çështja objekt gjykimi është në juridiksionin gjyqësor të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Vlore.

Për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, gjykata çmon se kerkese-padia është e pabazuar në ligj dhe në prova.

Fillimisht gjykata analizon pretendimin e palës paditese nëse jemi para një akti administrativ të pavlefshëm.

Në nenin 118 të K.Pr.Administrative parashikohet se :Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, kur ato anë nxjerre në kundërshtim me ligjin por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshëm.

Rezulton që akti administrativ njoftim-vlerësimi për detyrimet tatimore me nr.4285, datë 17.11.2014 është nxjerre në zbatim të ligjit 'për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë' të ndryshuar dhe ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 'Për tatimin mbi të ardhurat'.

Në nenin 13 të tij përcaktohet se 'Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë. 2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

Ne nenin 13.1 parashikohet se "Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga tatimpaguesi që mbart detyrimin për të deklaruar, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, dhe përmban të dhëna për të ardhurat bruto, për shpenzimet e zbritshme të kryera, si dhe për tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore. **2. Deklaruesi, në rast se konstaton gabime materiale të bëra nga ai vetë gjatë plotësimit të deklaratës, ka të drejtë që, brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës, të bëjë korrigjimet e nevojshme. Brenda këtij afati, individi ka të drejtë të bëjë korrigjimin e deklaratës deri në dy herë, pa u penalizuar. Nëse nga ana e tij korrigjimi brenda këtij afati tremujor ndryshon për herë të tretë, ndaj tij aplikohen sanksionet, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 115 "Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim" të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."**

10

Ne nenin 64 të ligjit 'Per procedurat tatimore në RSH' parashikohet se '1. Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës. 2. Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklaratës tatimore, tatimpaguesi bën vetëdeklarim të shumës së detyrimit tatimor apo të kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore dhe e paguan këtë tatim në afatin dhe vendin e përcaktuar në ligjin tatimor përkatës, pavarësisht nga shtyrja e afatit për dorëzimin e deklaratës tatimore. 3. Deklaratat dhe formularët e tjerë, që duhen dorëzuar nga tatimpaguesi, vihen në dispozicion të publikut, pa pagesë, nëpërmjet: a) publikimit në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore; b) sporteleve të njëjësive të shërbimit për tatimpaguesin; c) dërgimit me postë, duke përdorur shërbimin postar rekomandë, për ata tatimpagues, që paraqesin kërkesë me shkrim për ofrimin e këtij shërbimi. 4. Formatet e deklaratave dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet deklaratës tatimore, miratohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Ne nenin 67 të tij përcaktohet se "1. Tatimpaguesi mund të dorëzojë deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklaratat tatimore fillestare është e pasaktë dhe me mangësi. 2. Deklarata e ndryshuar mund dorëzohet brenda dymbëdhjetë muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare. 3. Dorëzimi i një deklaratë tatimore të ndryshuar përfshin: a) pagesën e çdo detyrimi tatimor shtesë; b) kamatëvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së dorëzimit të deklaratës tatimore të ndryshuar; c) kërkesën e tatimpaguesit për kreditimin e tatimit të paguar më tepër plus interesat e llogaritura për këtë periudhë, duke e llogaritur këtë shumë për llogari të detyrimeve tatimore të tjera, ekzistuese apo të ardhshme; ç) kërkesën për rimbursimin e tatimit të paguar më tepër, plus interesat. 4. Për llogaritjen e interesit të përmendur në pikën 3 të këtij neni, zbatohen dispozitat e këtij ligji për kamatëvonesat.

Rezulton se në nenin 115 të ligjit parashikohet se "1. Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë apo i një kërkesë të pasaktë për rimbursim dënohet me një gjobë të barabartë me 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar apo rimbursimit të kërkuar më tepër, për secilin muaj apo pjesë muaji, derisa shuma e detyrimit të paguhet plotësisht. Në asnjë rast shuma nuk mund të jetë më e madhe se 25 për qind e detyrimit të papaguar. 2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor ose e kërkesës së pasaktë të rimbursimit është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar, ose shumës së saktë të rimbursimit dhe shumës së tatimit të paguar apo rimbursimit të marrë në datën e caktuar.

Rezulton se pala paditese nuk e ka plotesuar dokumentacionin e munguar te kerkuar nga pala e paditur per sistemin te situates financiare dhe per kete arsye nuk eshte kryer sistemimi brenda afatit te caktuar ne ligj dhe per kete arsye shoqeria eshte denuar konform nenit 115 te ligjit 'Per procedurat tatimore ne RSH'.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet ka një vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale ne shkallë vendi, 315706(treqind e pesëmbëdhjetë e shtatëqind e gjashtë) lekë, dhe ne zbatim te nenit 45 te ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" kunder ketij vendimi nuk parashikohet ankim.

Sa më sipër, gjykata çmon se njoftim-vlerësimi për detyrimet Tatimore nr.4285, date 17.11.2014 nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat i cili nuk eshte shqyrtuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor me shkresen me nr.32364/3 prot, date 09.04.2015 eshte akt administrativ i nxjerre ne zbatim te ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile .

V E N D O S I

- 1.Rrezimin e kërkesë-padisë.
- 2.Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditese.
- 3.Kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më datë 15.09.2015

SEKRETARE

Edlira SHEHU

SHPENZIMET GJYQËSORE

Taksa e rregjistrimit
Total

GJYQTARE

Gentiana XHETILI (RROKAJ)

3000(tremije) lekë
3000(tremije) lekë